



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Kom.Dh.Shk.II.nr.979/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS NË PRISHTINË – Dhomat e shkallës së dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj-Sheremeti dhe Franciska Zhitija – Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të masës së sigurimit “Pandora A/S”, me seli në Havneholmen 17-19 DK-1561, Kopenhagë – Danimarkë, sipas autorizimit përfaqësohet nga REACT U.A Amstelveenseweg 864 Holandë si bartës i të drejtës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.L., avokat nga Prishtinë, kundër kundërshtarit të masës së sigurimit “Perla Jewelry” sh.p.k., me nr. identifikues 811390674, me seli në Ferizaj, rr. “Dëshmorët e Kombit” p.n, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V.M., avokat nga Ferizaji, duke vendosur lidhur me ankesën e kundërshtarit të sigurimit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e shkallës së parë-Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.2633/22 e datës 05/05/2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 24/07/2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kundërshtarit të masës së sigurimit “Perla Jewelry” sh.p.k., me seli në Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.2633/22 e datës 05/05/2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KE.nr.2633/22 e datës 05/05/2023, në piken I të dispozitivit të aktvendimit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurimit PANDORA A/S, me seli në Danimarkë dhe e ka caktuar masën e sigurimit për kundërshtarin e masës “Perla Jewelry” sh.p.k., me seli në Ferizaj, ashtu që të njëjtit i ndalohet ekspozimi, shitja apo çfarëdo forme e tregtimit të produkteve të cilat mbajnë marke tregtare “PANDORA” 013262, 018214 dhe 018068, kurse në piken e II të dispozitivit ka vendosur që masa e sigurimit të mbetet në fuqi deri në një vendim tjetër mbi masën e sigurimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kundërshtari i sigurimit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore në lidhje me ligjin për marka tregtare, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së, me propozim që Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, aktvendimin KE.Nr.2633/22 të dt.05.05.2023 ta ndryshon duke e aprovuar si të

bazuar ankesën e kundërshtarit të sigurimit, ashtu që të refuzohet propozimi i propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit ndaj kundërshtarit të sigurimit që ti ndalohej ekspozimi, shitja apo çfarëdo forme e tregtimit të produkteve të cilat mbajnë markën tregtare Pandora 013262, 018214 dhe 018068 nën kërcënimin e pasojave juridike deri në një vendim tjetër gjyqësor, apo të prishet aktvendimi KE.Nr.2633/22 të dt.05.05.2023 dhe çështjen t’ia kthej dhomave të shkallës së parë në procedim të serishëm në rivendosje.

Propozuesi i sigurimit nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesja e masës së sigurimit “Pandora A/S”, me seli në Havneholmen 17-19 DK-1561, Kopenhagë – Danimarkë përmes përfaqësuesit të autorizuar me datën 02.11.2022 ka parashtruar padi për shkelje të markës tregtare se bashku me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, kundër kundërshtarit të masës së sigurimit Perla Jewelry” sh.p.k., me nr. identifikues 811390674, me seli në Ferizaj, rr.’Dëshmorët e Kombit” p.n, duke kërkuar nga gjykata aprovimin e saj si të bazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës të sigurimit, me aktvendimin e atakuar, e ka aprovuar në tërësi propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, si të bazuar, duke vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me Nenin 297 par.1 pika a) dhe b) të LPK-së, dhe nenin 79 të Ligjit për Markat Tregtare.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e shkallës së dytë, e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së e po ashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e shkallës së dytë, e mori këtë qëndrim juridik për arsye se Neni 79 të Ligjit për Markat Tregtare (LMT) par.1 parasheh se “ *Me kërkesën e pronarit të markës tregtare i cili dëshmon se marka tregtare është shkelur apo tentohet të shkelet, gjykata mund të shqiptoj çfarëdo mase të përkohshme që përfshin ndalimin apo parandalimin e shkeljes dhe në veçanti: 1.1. të urdhëroj shkelësin e supozuar që t’i ndalojë dhe t’i ndërpresë veprimet që shkelin markën tregtare; gjykata po ashtu mund të lëshojë një urdhër ndalimi kundër ndërmjetësuesit shërbimet e të cilit i përdorin personat e tretë që shkelin markën tregtare; 1.2. të urdhëroj konfiskimin apo largimin nga tregu të produkteve që pa të drejtë emërtohen si marka tregtare*”. Prandaj, kjo gjykatë vlerëson se propozuesi i masës së sigurimit në këtë rast e ka provuar se është shkelur marka e tij tregtare “PANDORA” nga kundërshtari i sigurimit në kuptim të nenit 9 të Ligjit (NR. 08/L-075) për markat tregtare.

Kjo gjykatë vlerëson se Ligji për Markat Tregtare i jep të drejtë bartësit të së drejtës nga marka tregtare që në rastin e shkeljeve të kryera në veprimtari afariste, në qoftë se dëshmon se shkelja është kryer me qëllim të përfitimit material dhe shkelja ka tentuar t'i shkaktojë atij dëm të riparueshëm apo vështirë të riparueshëm, të kërkoj nga gjykata caktimin e masës së sigurimit. Në rastin konkret, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton se propozuesi e ka bërë të besueshme se kundërshtari i sigurimit me veprimet e tij, përfshirë përdorimin e shenjës, shërbimet, produktet, dhe shenjat tjera të përdorura, ka cenuar markën e tij tregtare "PANDORA".

Kushtet dhe procedura për përcaktimin e masës së sigurimit pjesërisht përveç Nenit 79 të LMT-së, përcaktohet me Nenin 297 të LPK-së. Sipas Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se: *"Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtyre palave kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit"*. Kjo gjykatë vlerëson se në bazë të propozimit për caktimin e masës të paraqitur dhe provave nga shkresat e lëndës, dëshmitë e regjistrimit dhe pronësisë së markës tregtare të propozuesit për "PANDORA", ku nga këto vërtetohet pronësia e markave tregtare "PANDORA" dhe vlefshmërinë e regjistrimeve të tyre në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe legjitimacionin real aktiv të propozuesit të masës së sigurimit sa i përket ushtrimit të së drejtave pronësore për markat në fjale.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e shkalles së dytë vlerëson se nga shkresat e lëndës është vërtetuar fakti se kundërshtari i masës së sigurimit ka kryer shitje të produktit nën përdorimin e emrit të markës tregtare "PANDORA", ku kjo u vërtetuar në bazë të fotografive të dyqanit i cili përmban produktet e biznesit të kundërshtarit të masës dhe i njëjti i është dhënë blerësit me rastin e blerjes se produkteve nën shenjen emrin "Pandora".

Kjo gjykatë i vlerësoi pretendimet e kundërshtarit të masës së sigurimit sa i përket biznesit ndaj të cilit është paraqitur propozimi për caktimin e masës së sigurimit është shuar, mirëpo këto pretendime i vlerësoi si të pabazuar, me arsyetimin se kundërshtari i masës së sigurimit nuk ka paraqitur asnjë provë për të mbështetur një pretendim të tillë, dhe nga të dhënat në Regjistrin Publik të ARBK-së, sipas numrit identifikues unik:811390674, tek statusi i subjektit figuron si biznes i regjistruar.

Kjo gjykatë i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të kundërshtarit të masës së sigurimit, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pabazuar.

Bazuar në të lartcekurat, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, që të caktohet masa e sigurimit, sepse në rastin konkret propozuesi e ka bërë të besueshëm

ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do t`i shkaktohej dëm i konsiderueshëm i cili vështirë do të mund të riparohej.

Prandaj kjo gjykatë, konsideron se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 297.1 të LPK-së, dhe nenin 79 par.1 të Ligjit për Markat Tregtare që të caktohet masa e sigurimit.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d) e lidhur me nenin 209 par.1 nën pikën b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e shkallës së dytë,
Kom.Dh.Shk.II.nr.979/2023, dt.24.07.2023**

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari
Faton Bajrami, d.v**